




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 23

Datë: 05.05. 2020.

KONTRATË PROKURIMI Nr 06

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe
"M & Sillosi" SH.P.K me seli në Rahovec me Nr.biznesi 810502783 (në vazhdim
 "Operatori Ekonomik"), ne anën tjeter, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

FURNIZIM ME MIELL PËR FAMILJET SKAMNORE ME RASTIN E SHFAQJES SË PANDEMIS SË COVID-19 DHE KARANTINËS SË CAKTUAR NGA QRKS
 me numër identifikues: **62500.20.025.136**

Neni 1. Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: FURNIZIM ME MIELL PËR FAMILJET SKAMNORE ME RASTIN E SHFAQJES SË PANDEMIS SË COVID-19 DHE KARANTINËS SË CAKTUAR NGA QRKS.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen e furnizimit me miell.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.
- 1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: Në Malishevë.
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP³ (Detyra e Dërguar e Paguar).

³ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2. Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3. ÇMIMI

3.1 Çmimi total i kontratës është: **9.900,00€** (me shkronja) :

(nëntëmijëenëntëqindëeuro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë maksimumi i pagesës (sipas sasis se planifikuar) që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3. Menaxhimi i Kontratës

Menaxhimin e Kontratës furnizim me miell përfundon me rastin e shfaqjes së pandemis së COVID -19 dhe karantinës së caktuar nga QRKS do ta e bëjë një komision i caktuar nga ZKA-ja e AK-së.

Neni 3.4 Obligimet e OE

Furnizim me miell duhet të kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga autoriteti kontraktues dhe në përpjekshmëri me specifikacionin e ofertës dhe me afatë të mjaftueshem të përdorimit. Nëse Furnizim me miell nuk kryhet në cilësi dhe sasi (sipas specifikacionit të ofertës) dhe me afatë te mjaftueshmëri të përdorimit do të i kthehen operatorit ekonomik dhe shpenzimet e bëra biejnë në llogari të operatorit ekonomik. Furnitorit do të i kthehen edhe furnizim me miell i dërguara pa porosi të kontraktuesit të parë.

Neni 3.4 Afati i furnizimit

Furnizimi me miell do të bëhet brenda **30 ditëve** që nga dita e nënshkrimit të kontratës sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Neni 4. PAGESA

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e pranimit nga komisioni i caktuar nga ZKA i AK-së të furnizimit me miell për familjet skamnore me rastin e shfaqjes së pandemis së COVID -19 dhe karantinës së caktuar nga QRKS dhe faturën se nga kontraktuesi i dytë (OE), t'ia paguaj shumën sipas nen. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5. Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6. Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtuara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7. Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për _____ muaj, pas pranimit të *[furnizimeve]* *[shërbimeve]* *[punëve]*.

Neni 8. Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]* *[të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]* *[te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës

aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të konratës.

Neni 9. Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshterinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas konratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshteria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10. Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkonratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të konratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11. Ndërprerja e Konratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë konratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas konratës; b) Dështon në ekzekutimin e konratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt konratën apo nënkonratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjeter ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të konratës.

Neni 12. Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 . Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.


13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14. Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuhi Shalaj
Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	26. 03. 2020
Vula:	

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Dardan Shala
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	26. 03. 2020
Vula:	

PJESA II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PJESA <Nr>

NR. I ART.

PERSIKRIMI

NR. I ART.	PERSIKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA KG	QUMMI PËR NJËSI PA TVSH €	TVSH (%)	QUMMI PËR NJËSI ME TVSH €		QUMMI TOTAL ME TVSH €
						TOTALI I PËRGJITHSHËM:	Furnizimi me miell të cilësisë se lartë IIP 500	
1			30000	0,279661	0,0533	0,33	9,900,00	



1977

Ylli

9,900,00